



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 12,14 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 10 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës e datës 22 nëntor 2012, nenit 20 paragrafi 3 pika 3.3 të Rregullores QRK Nr.23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe nenit 9,17,20 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 të dt.26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 28. 02. 2019, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

**VENDIM
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE KËSHILLIT TË
BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR VARREZA NË FSHATIN RUBOFC**

Neni 1

Me këtë vendim, ipet në shfrytëzim afatgjatë prej 99 vitesh pronat komunale, Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan, si në vijim:

1. Parcela kadastrale P-71409068-00756-0 në vendin e quajtur "Drum çeramdnica" me kulturë arë e kl.3-të me sipërfaqe prej 3517m² Zona kadastrale Rubofc, P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan.
2. Parcela kadastrale P-71409068-00757-0 në vendin e quajtur "Drum" me kulturë jo Pjellore me sipërfaqe prej 4976 m² Zona kadastrale Rubofc, P.Sh. e Kuvendit Komunal Lipjan.

Neni 2

Pronat komunale siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi ipen në shfrytëzim me destinim për varreza në fshatin Rubofc dhe nuk mund të shfrytëzohen për qëllime tjera.

Neni 3

Me këtë Vendim obligohet Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në lidhje me procedurën e regjistrimit, KK Lipjan shfrytëzues Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan me destinim për varreza, siç përcaktohet në nenin 1 të këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektorit pronësoro-juridik, Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Shërbime Publike.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 463-14826

Lipjan, më 04. 03. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

